



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1617/16 Prot

Durrës, më: 24.06.2026

V E N D I M

Nr. 96, datë 24.06 2026

PËR

**"RIORGANIZIM NË MASËN NËN 20% TË PROGRAMIT TË STUDIMIT ME
KARAKTER PROFESIONAL 2- VJEÇAR NË "EDUKATOR PËR MOSHËN 0-3
VJEÇ", PRANË FAKULTETIT TË EDUKIMIT, TË UNIVERSITETIT
"ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Statutin e UAMD; Rregulloren e UAMD; si dhe referuar në relacionin e Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave me Nr. 800/2 prot., datë 11.06.2026, në mbledhjen e datës 24.06.2026, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e riorganizimit në masën nën 20% të programit të studimit me karakter profesional 2- vjeçar në "Edukator për moshën 0-3 vjeç", pranë Qendrës për Edukim në Vazhdim, në Fakultetin e Edukimit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët,
 - Drejtuesi i Njesisë Kryesore FE,
 - Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave.
3. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2026-2027.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

